

RRJETI PËR ZHVILLIM RURAL I
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

e-buletini
no.11

**Korrik -
Dhjetor 2015**

www.ruralnet.mk

PUBLIKON

Rrjeti për zhvillim rural i
Republikës së Maqedonisë

"Kosta Veselinov" 3a,
1000 Skopje
R. e Maqedonisë
T: +389 (2) 3075 506
F: +389 (2) 3075 503
email: info@ruralnet.mk



**Në këtë numër...**

- 1**
faqe 4 **Aktivitete të Shoqatës së Artistëve
Artizanë ARTI KRAFT**
- 2**
faqe 6 **Ekipi i CeProSARD ka hartuar dhe prezantuar
Kornizën për Shpërngulje (RPF)**
- 3**
faqe 7 **Aktivitete të organizatës së grave
“Cvet” nga Krusheva**
- 4**
faqe 8 **Katalog i produkteve ushqimore të konservuar**
- 5**
faqe 9 **Projekti “ORGANIKA”**
- 6**
faqe 10 **Aktivitete të Eko Logik**
- 7**
faqe 14 **Aktivitete të Art Point – Gumno**
- 8**
faqe 16 **Ditët e Bletarisë Maqedonase**
- 9**
faqe 17 **Këshillim rajonal për bletari**
- 10**
faqe 18 **Panairi i mjaltit në Strugë**
- 11**
faqe 19 **Dita ndërkombëtare e gruas rurale**
- 12**
faqe 20 **Mësimi gjatë gjithë jetës për zhvillim rural**
- 13**
faqe 21 **U zhvillua LEADER Fest-i i parë në Dellçevë**
- 14**
faqe 22 **Promovim i bukurive në mjediset rurale**
- 15**
faqe 24 **Ngritja e kapaciteteve për përgatitjen e
aplikacioneve për projekte**
- 16**
faqe 25 **Zvogëlim të efekteve negative nga ndryshimet
klimatike mbi perimet**





17
faqe **26**

Zvogëlimi i efekteve negative nga ndryshimet klimatike tek pemët

18
faqe **27**

Zvogëlimi i efekteve negative nga ndryshimet klimatike në vreshtarinë

19
faqe **28**

Ulja e ndikimit negativ nga ndryshimet klimatike mbi erozionin e dheut



20
faqe **29**

Prezantim të matjeve të nisjes në fushën e blegtorisë

21
faqe **30**

Shirita mbrojtëse si masë për uljen e erozionit të dheut

22
faqe **31**

Projekti i USAID për Adaptimin e Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike ju ndihmon fermerëve të zvogëlojnë dëmet nga ndryshimet klimatike



23
faqe **32**

Dita e Grupit Lokal të Aksionit Bellasicë – Ograzhden

24
faqe **33**

Klima ndryshon, nga ne varet

25
faqe **34**

Konferenca për LEADER/ZLUK në Milano



26
faqe **35**

E gjithë Evropa do të jetojë! Njerëzit nga viset rurale në Evropë i afirmojnë të drejtat e tyre





1

Aktivitete të Shoqatës së Artistëve Artizanë ARTI KRAFT



Ishin përcaktuar aktivitete prej të cilëve një pjesë ishin zbatuar në 2015 dhe do të vazhdojnë edhe në 2016:

- zyrtarizimi i rrjetit;
- organizim i shfaqjes dhe ekspozitës;
- organizimi i pazareve;
- organizimi i pazareve për Vitin e Ri në Tiranë, Prishtinë, Shkup dhe Tetovë;
- përgatitja e katalogut me fotografi të punës dhe adresa të artizanëve nga rajoni;
- përpunimi i internet faqes së Rrjetit dhe materiale tjera promovimi që do të përshkruajë praktikat pozitive dhe do të mundësojë shkëmbim të njohurive dhe përvojave mes artizanëve dhe shoqatave të rajonit.

Në periudhën prej korrik deri në dhjetor, Arti Kraft ka organizuar disa ngjarje, manifestime, pazare dhe takime në Maqedoni, si dhe në Mal të Zi, Turqi, Kosovë dhe Shqipëri, për të promovuar artizanin dhe ruajtjen e traditës së vprave unike.

Ideja për formimin e Rrjetit të Artizanëve nga Ballkani, e dhënë më 15 maj 2015 në Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë, në Ditën Botërore të Sipërmarrjes për Gratë, ka sjellë rezultate pozitive në formë të takimeve të shumtë dhe pazareve, të cilat në periudhë prej gusht deri në dhjetor 2015 janë mbajtur në vende të ndryshme si: Mal të Zi (Ulqin), Turqi (Golçuk), Kosovë (Prishtinë), Shqipëri (Tiranë dhe Gjirokastrë) dhe në Maqedoni (Shkup, Tetovë dhe Gostivar).

Bashkëpunimi filloi me nënshkrimin e Memorandumit për Bashkëpunim,

njohje me bukuritë kulturore, historike dhe turistike, identifikimi i problemeve në artizanin, mes të cilave ishte theksuar edhe mungesa e përdorimit të programeve kombëtare për zhvillimin e artizanëve dhe vlerave tradicionale.





ale dhe krijimin e parakushteve për bashkëpunim më afatgjatë në zbatimin e iniciativave të ndryshme për zhvillimin e sektorit. Aktivitetet e planifikuara përfshijnë: organizimi i panaireve, pazareve, ekspozitave, forumeve, hapje të galerive të përbashkëta në vendet që vijnë anëtarët e Rrjetit dhe përcjellja e praktikave pozitive dhe njohurive.

Me rrjetëzimin zyrtar të organizatave joqeveritare për paraqitje të përbashkët para publikut donator dhe institucioneve kombëtare, bashkëpunimi i ndërsjellë për zbatimin e ideve të përbashkëta, transferimi i përvojave pozitive dhe praktika, si dhe krijimi i mekanizmave për zhvillim dhe promovim të artizanisë, do të rrit kapacitetin e shoqërisë qytetare dhe nivelin e përgatitjes për përballimin me çështje kryesore për mbijetesë dhe zhvillim të artizanisë në rajon.

Në këtë drejtim, një grup i entuziasteve u bashkuan në krijimin e një sistemi të organizuar për promovimin dhe përdormi në vlerave tradicionale dhe kulturore, me anë të bashkimit të artizanëve që veprojnë dhe jetojnë në rajonin.





2

Ekipi i CeProSARD ka hartuar dhe prezantuar Kornizën për Shpërngulje (RPF)



Korniza për Shpërngulje (RPF) është një dokument – udhëzues i Bankës Botërore për shpërngulje të popullatës, blerje të tokës, shpërngulje të kiosqeve, bizneseve të vogla që i ndjek praktikata më të mira ndërkombëtare. Dokumenti është një kornizë që duhet të merr parasysh interesat e gjitha palëve të interesuar dhe të kontribuojë për zgjidhjen e problemeve që rrjedhin si rezultat i interesave të kundërshtuara për revidim të kërkesave maksimaliste të çdo pale në kërkesa të kuptueshme.

Në organizim të Ministrisë së Financave më 8 tetor 2015 u mbajt në prezantim dhe debat publik për do-

kumentin “Korniza për politikën e shpërnguljes” për projektin e dytë të përmirësimit të shërbimeve komunale - MSIP-2.

Gjatë prezantimit dhe debatit publik, përveç përfaqësuesve të Bankës Botërore, kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të institucioneve (Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikim Hapësinor, Qyteti i Shkupit, Ministria e Financave); përfaqësues të sektorit joqeveritar (Aleanca e Shoqatave Qytetare “Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë” – RZR i RM”) dhe sektori afarist (Trajkovski & Partnerët – menaxhim dhe konsultim) etj.

<http://www.finance.gov.mk/mk/node/1056>

http://www.finance.gov.mk/files/u5/Resettlement_policy_framework_WB_Disclosure.pdf





3

Aktivitete të organizatës së grave “Cvet” nga Krusheva

Organizata e grave “Cvet” nga Krusheva, anëtare e Rrjetit për Zhvillim Rural, vazhdon në mënyrë aktive të punojë në afirmimin e kulturës krushevale dhe traditës me anë të përgatitjes së specialiteteve krushevale për ngjarje të ndryshme të organizuara nga vetëqeverisja lokale, si dhe me anë të organizimit të Etno Panairit në periudhën prej 1 dhjetor 2015 deri më 30 janar 2016.

Ngjashëm me vitet tjera, edhe këtë vit “Cvet” ka marrë pjesë në shënimin tradicional të festës fetare “Deva” më 5 janar, si tradita e vetme e Maqedoni që mbahet vetëm në Krushevë.





Katalog i produkteve ushqimore të konservuar

Fondacioni për Zhvillim Lokal dhe Zhvillim të Teknologjive Informative nga Gjevgjelia në partneritet me Shoqatën për Edukim të Fëmijëve dhe Rinjve Sllozhuvallka ka zbatuar projektin "Promovimi i kapaciteteve lokale me katalog të produkteve ushqimore të konservuar". Projekti ishte mbështetur nga Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë me anë të projektit të USAID për Adaptimin e Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike në sajë të Mekanizmit Projektues të Rrjetit.

Përpunimi i produkteve bujqësore është një prej shtytësve kryesor ekonomik në rajonin e Gjevgjelië-Vallandovës. Ky rajon, që përbëhet nga katër komuna, Gjevgjelia, Bogdanci, Dojrani dhe Vallandova, në territorin e saj ka dhjetëra kompani që merren me përpunimin e pemëve dhe perimeve. Në sajë të projektit ishte përpunuar një Katalog të Produkteve Ushqimore të

Konservuar në të cilin janë promovuar 5 kompani. Qëllimi ishte të bashkohet oferta rajonale e produkteve të përpunuara dhe konservuara dhe të tregohet për cilësinë dhe kërkesën e

produkteve që rrjedhin nga ky rajon. Katalogu është shtypur në 700 kopje dhe do të shpërndahej gjitha kompanive dhe palëve tjera të interesuar që kanë marrë pjesë në projektin.





5

Projekti “ORGANIKA”

Shoqata Instituti për Zhvillimin e Bashkësisë (IZB) – Tetovë, në kuadër të aktiviteteve të programi, punon në realizimin e projektit “Organika”.

Projekti është pjesë e aktiviteteve të Rrjetit për Zhvillim Rural të R. së Maqedonisë, për mbështetjen e iniciativave të projektit të organizatave anëtare. Projekti është me kohëzgjatje prej dy muajve.

Partner i projektit është Shoqata e Fermerëve Gra Moja Farma - Gostivar.

Qëllimi i projektit është rritja e interesit të fermerëve për prodhimtari të ushqimit organik, përvetësimin e njohurive, shkathtësive të qytetarëve për prodhimtari më cilësore të ushqimit organik me anë të konsultimeve, këshillimeve, informimit, edukim të qytetarëve. Aktivitetet në kuadër të projektit do të përmirësojnë punën e tyre me çfarë do të ndikohet mbi të ardhurat e familjeve dhe do të kontribuojë për zhvillimin rural.

Në kuadër të projektit Organika ishin parashikuar dhe realizuar disa aktivitete të projekteve:

1. Faza përgatitore
2. Punëtori me fermerë
3. Krijimi i ueb faqes
4. Konferencë

Konferenca ishte aktiviteti përfundimtar i projektit në sajë të projektit Organika dhe u zhvillua më 10 gusht 2015.



Rezultate nga konferenca:

- Pjesëmarrës të informuar për përvojat e aktiviteteve të zbatuar të projektit Organika;
- Panel diskutime me të cilat pjesëmarrësit kanë fituar më tepër njohuri nga fusha e prodhimtarisë organike;
- Në konferencën ishte promovuar ueb faqja Organika dhe mundësitë që ofron;
- Pjesëmarrësit ishin njoftuar me asortimentin e produkteve organike të prodhueseve që kanë ekspozuar produktet e tyre në konferencë;
- Kontakte të realizuar dhe drejtime për bashkëpunim të ardhshëm mes

fermerëve;

- Promovim i idesë dhe trendit botëror që ushqimi organik është parakusht për zhvillim rural.

Me inkurajimin e fermerëve për shoqërimi ne tyre, identifikimin e perspektivave dhe interesave të përbashkëta, drejtpërdrejtë do të ndikohet edhe në përforsim ne ekonomike bujqësore, transferim të njohurive dhe përvojave për prodhimtari të ushqimit të shëndetshëm. Ajo do të sjell edhe përforsim të kapaciteteve të fermerëve për punë të mëtutjeshme dhe aktivitete, si dhe përmirësim të jetës dhe zhvillim të komunitetit.

Për më tepër informacione, vizitoni ueb faqen në www.irz.org.mk





6 Aktivitete të Eko Logik

Punëtori në Brejnobrejn

Në muajin nëntor, ekipi i Eko Logik, ka organizuar punëtori në zyrat e Brainobrain International Macedonia dhe Brainobrain Abacus Aerodrom. Grupi synues i këtyre punëtorive kanë qenë fëmijë të moshës mes 5 dhe 10 vjeç.

Në përputhje me misionin e këtij institucioni arsimor që është të nxit gjenialitetin e fëmijëve, ne me këto punëtori i njoftuam me burimet e ripërtëritë dhe jo-ripërtëritë të energjisë.

Gjatë punëtorisë ishte mbajtur edhe një eksperiment në të cilën gjenitë e vegjël kanë përdorur energjinë e ujit të ngrenë një ngarkesë të vogël.



Edukim për energji

Ekipi i “Eko Logik” si pjesë e projektit „Edukimi për rëndësinë e energjisë, mënyrës së prodhimit dhe përdorimit me anë të teorisë dhe praktikës”, ka realizuar punëtori në shkollat fillore të komunave Ilinden, Karposh dhe Qendër. Punëtoritë ishin të zbatuar me sukses, në ato kanë marrë pjesë nxënësit e klasave të V, VI dhe VII që kanë treguar rezultatet jashtëzakonisht pozitive.


Projekti zbatohet nga Eko Logik dhe është mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Projekti ka filluar me realizimin në janar të vitit 2015 dhe do të zgjat deri në mars të vitit 2016.



EKO LAGJE

Në tremujorin e fundit, paralelisht me aktivitetet tjera, ekipi i Eko Logik ka punuar në zhvillimi në lojë të parë shoqërore për efikasitet energjetik në Maqedoni “EKO LAGJE” që ka për qëllim që më afër, në mënyrë kreative dhe interesante të prezantojë rëndësinë e zbatimit të praktikave për efikasitet energjetik dhe mbrojtje të mjedisit jetësor.

Me anë të mënyrave të ndryshme interaktive, lexim, përgjigje të pyetjeve të kuiz dhe zbatimi teorik i praktikave energjetike-efikase, lojtarët e moshave nga tetë vite e më të moshuar do të kenë mundësinë të mësojnë dhe të bëhen më të vetëdijshëm për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit jetësor. Koncepti dhe paraqitja janë të ngjashme me lojërat tjera shoqërore dhe ishte bërë për të pranuar më lehtë.



Loja “EKO LAGJE” del si rezultat i projektit aktual që Eko Logik e zbaton “Edukimi për rëndësinë e energjisë, mënyrës së prodhimit dhe përdorimit me anë të teorisë dhe praktikës”.



Jetë cilësore dhe qëndrueshmëri – punëtori në SHMK “Nikolla Karev”

Eko Logik në kuadër të projektit “Jetë cilësore dhe qëndrueshmëri”, i mbështetur nga Qyteti i Shkupit ka organizuar dy punëtori informative në shkollën e mesme të Shkupit “Nikolla Karev”.

Qëllimi i këtyre punëtorive është të rritet vetëdije e nxënësve të shkollave të mesme në kuptim të qëndrueshmërisë dhe mjedisit jetësor. Punëtorja e parë ishte dedikuar ushqimit të shëndetshëm kur ishte biseduar për rëndësinë dhe ndikimin mbi organizimin e njeriut. Ndërsa në punëtorinë e dyte ishte diskutuar për biçikletat, gjegjësisht për mundësinë e përdorimit të tyre si mjet kryesor i transportit për nxënësit e shkollave të mesme.



Panel diskutim për partneritet në komunikacion

Më 17.09.2015, Eko Logik ka organizuar diskutim për siguri në komunikacion, ku të ftuar ishin përfaqësues të komunave Gjorqe Petrov dhe Qendër, përfaqësuesit e NP të Komunës Qendër, përfaqësues të grupit joformal NaTocak, përfaqësues të policisë rrugore, përfaqësues të KR-SKRR.

Gjatë diskutimit janë shpërndarë të dhëna të deritanishme statistikore për gjendjen e deritanishme në trafik dhe numrin alarmant të aksidenteve që ndodhin çdo ditë. Inspektori për punë në komunikacion gjatë SPB Shkup ka theksuar gjendjen e përditshme shqetësuese dhe përpjekjet e tyre për përballimin e tyre.

Pjesa më e madhe e diskutimit ishte fokusuar në përparësitë, mungesat



dhe mënyrat e rritjes së numrit të vozitësve të biçikletave dhe përdorimit të biçikletës si mjet transportimi. Ishin prezantuar shembuj ndërkombëtar,

shembuj pozitiv të vendit ishin theksuar ndërsa ishte biseduar edhe për plane të ardhshme për zhvillimin e transportit me biçikletë nëpër qytetin.

Projekti „SMILE“



Projekti S.M.I.L.E. (Soft Mobility Integrated Learning in English) është një projekt mes partnerëve të organizatave nga Italia, Maqedonia, Belgjika, Lituania dhe Greqia të realizuar me anë të programit ERAZMUS +.

Qëllimet e projektit:

1. Të promovojë përdorimin e Content and Language Integrated Learning (CLIL) me anë të miratimit të qasjeve inovative arsimore dhe praktika joformale arsimore në bazë të kreativitetit dhe argëtimit, si dhe vegla efektive të mësimit.
2. Të mbështetet mësimi i bazuar në probleme, me anë të zhvillimit të metodikës mësimore për të promovuar qytetarinë aktive dhe të ngrit vetëdijen tek nxënësit me

pyetje lidhur me mobilitetin e qëndrueshëm në mjedise urbane.

3. Të zmadhojë integrimin digjital në procesin e mësimit, me anë të mbështetjes së mësimdhënësve dhe edukatorëve joformal në përfitimin dhe avancimin e përdorimit të TIK për aktivitete të mësimit.
4. Të promovojë rrjetin e shkollave në nivelin e Evropës dhe të përçohet lidhja mes shkollave dhe organizatave të shoqërisë qytetare, me anë të integritit të praktikave joformale arsimore në programet mësimore dhe nxitjen e bashkëpunimit mes mësimdhënësve dhe edukatorëve joformal.

Organizatrat partnere:

- PRO4GEO, Itali;
- RE-BIKE, Itali;
- EURO GEO, Belgjikë;
- ZALI, Lituani;
- PAEPSM, Greqi;
- ECO LOGIC, Maqedoni.



Në kuadër të këtij projekti ishte organizuar edhe mbledhja e parë e punës në Vilnius, Lituani.



Garë ndaj përvojë personale

Ekipi i Eko Logik në sajë të projektit “Jetë cilësore dhe qëndrueshmëri” ka organizuar një garë me titullin “Ndaj përvojë personale”.

Në këtë garë kanë të drejtë të marrin pjesë gjithë nxënësit e shkollave të vitit të tretë dhe katër të shkollave të mesme të qytetit të Shkupit. Qëllimi i garës ka qenë që ata të ndajnë përvojën e tyre personale lidhur me një nga temat: mjedisi jetësor, transporti, ushqimi dhe strehimi.

Për atë qëllim, ishte krijuar edhe blogu <https://mladizaodrzhivost.wordpress.com/>.



Garë Velo rodeo

Si pjesë e aktiviteteve në kuadër të Javës Evropiane për Mobilitet, ekipi i Eko Logik ka organizuar një ngjarje edukative-garuese “Velo Rodeo”, të mbështetur nga Triatlon Federata e Maqedonisë, të sponsoruar nga Outdoor MK, EU Info Qendra, Vitalia, Neskuik dhe Neskafe.

Ekipet ishin në përbërje të përzier me pjesëmarrje të burrave dhe grave në moshë prej 10 deri 14 vite. Në kohëzgjatje prej gjithsej 10 minuta, pjesëmarrësit me sukses kanë zbatuar sfidën që



përbeheshe nga dhjetë ushtrime me biçikletë, kanë treguar një frymë të madhe të ekipit dhe garës dhe me meritë kanë marrë dhuratat që sponsoret kanë siguruar për ata.






Aktivitete të Art Point – Gumno

1. Manifestimi i 9-të “FESTIMI I PIREJIT”

Në mënyrë tradicionale, më 28 gusht, “Art Point – Gumno” në bashkëpunim me shtëpinë e produksionit “ENOH” ka organizuar manifestimin multimedial “FESTIMI I PRIJEIT”. Kremtimi i nëntë për kreun e literaturës maqedonase Petre M. Andreevski filloi afër varrit të tij në fshatin Slloeshticë, me fjalim të prof. Dr. Elisabeta Sheleva.

„...Tek Petre M. Andreevski dashuria ndaj vendlindjes dhe kulturës kombëtare, tradita që në mënyrë natyrale kondensohet, në formë të një emocioni ikonik dhe singertë, e vlefshme për sfidat më të mëdha dhe më të larta krijuese. Kjo besnikëri dhe dashuri ndaj atdheut nuk është fryt i një koketeri të paturpshme, pozë retorike, as të folurit konformistik ndaj “autoriteteve” mentale të pushtetit.




Në këtë kuptim, Petre mbetet i rreptë dhe kritik, njëlloj sikur çdo autor që nuk blihet, që me dinjitet ka mbajtur gjithçka para integritetit dhe nderit të tij – duke dikur që si “njeri i fjalës” – ajo është e gjitha që ka, dhe lehtë mund të humbet, nëse i zhgënjën parimet e veta të rrepta artistike dhe natyra e tij që nuk blihet”. – ka shkruar Sheleva.

Programi ka vazhduar në gumnon artistike, ku ishte hapur një ekspozitë e veprave të krijuar gjatë rezidencës artistike ndërkombëtare të Art Point – Gumno 2015 si dhe të portret-fotografive të artistëve të fotografit maqedonas Sasho N. Alushevski.

Në gumnon janë promovuar edhe rezultatet e projektit “Përshëndetni zogjtë nga mali Ilnit dhe Pllakenit” që organizatorët e kanë zbatuar me mbështetjen e Shoqatës Ekologjike Maqedonase dhe Euronatur nga Gjermania.

Një “veçori” e posaçme e programit ishte edhe shfaqja origjinale në skenë: “Përralla të rrëfyer nga gjyshi Ilija Kočovski” në performancën e treshit të aktorëve të rinj (Toni Denkovski, Damjan Cvetanovski dhe Sergej Dimovski, të gjithë me origjinë nga f. Slloeshticë) dhe regji të Andrej Cvetanovski. Cvetanovski është edhe autor i filmit dokumentar “Kafshë” (dedikuar babait të tij, profesorit të vdekur dhe regjisor Vllado Cvetanovski) që kishte premierën në skenën – “Mostot Bela Reka”.

Manifestimi ishte pjesërisht i mbështetur nga Ministria e Kulturës së RM-së dhe kryetarit të komunës Demir Hisar, z. Lupço Bllazhevski.





2. Përfundim i suksesshëm i projektit: “PËRSHËNDETNI ZOGJTË NGA MALI ILNIT DHE PLLAKENIT!”

ПОЗДРАВЕТЕ ГИ ПТИЦИТЕ ОД ИЛИНСКА И ПЛАКЕНСКА ПЛАНИНА!

Пред нас е планинскиот масив што го сочинуваат Илинска и Плакенска Планина – регион чијашто најмногу претставува karakteristika e bogatost biolozičeskata. Raznovidnosta i unikatnata flora gi zbrojuva ovie planini meŭ 42-te Značajni rastitelni podračja vo Republika Makedonija što sekaŭo pridonesuva tie da bidad dom i na brojni životinski vidovi. Za divite životni, ovoj region pretstavuva i isključitelno važen koridor što gi povuza edinstvenite tri nacionalni parkovi vo zemjara.

Ptiците pretstavuваат važen del od ekosistemot, važni indikatori za sostojbata so životnata sredina, tie se čuvari na šumite, prijeteni na zemjoedencite, eden od najmošnite simboli vo kulturata i vo narodnata tradicija i keruvana.

Blagodarjenje na anketite spovedeni vo regionot na ošitina Demir Hisar vo periodot april – juli 2015 god, del od lokalnite žitelji identifikuvaa rečnici 90 vidovi ptiци. Ovie rezultati gi sporednive so rezultatite dobieni od strana na členovite na Ornitofoaunata sekcijska pri Istrakuvačkoto društvo na studentite biologii od Makedonija konito vo 2008 god. to spovedoa prvo podetalno ornitološko istrakuвање na Iliniska i Plakenska Planina (vo literaturata pošto ne može da se najat predočni podatoci). Provalnie, deka vo ovoj region redovno tsekaat vidli pripremeno, za vreme na nivnite migracii, prestoiuak повеќе od 100 vidovi ptiци! Ova pretstavuva rečnici 1/3 od vkuipo 332 vidovi od ornitofaunata registrirana vo Makedonija – dovolen potтик za novi, podetalni istrakuvaња od strana na biologite! Veruваме deka pri našeto putuвање viz regionot ќе se sretne del od ptiците.

ПОЗДРАВЕТЕ ГИ!

GREET THE BIRDS OF ILINSKA AND PLAKENSKA MOUNTAINS!

You are standing in front of the mountain range composed out of Ilinska and Plakenska Mountains – a region with rich biodiversity as its most impressive characteristic. The diverse and unique flora lists these mountains amongst the 42 important plant areas in the Republic of Macedonia. This is a home of numerous animal species too. By connecting all three National Parks in the country it represents a uniquely important corridor for the wildlife.

The birds are inseparable part of the ecosystem, important indicators for the state of the environment, they are guardians of the forests, friends of the farmers, one of the most powerful symbols in the culture and in the folk traditions and beliefs.

Thanks to the field survey carried out in the region of Demir Hisar Municipality in the period of April – July 2015, part of the local citizens identified nearly 90 bird species. We then compared these results with the ones obtained by the members of the Biology Students' Research Society from Macedonia, which conducted the first more detailed ornithological survey on numerous locations on Ilinska and Plakenska Mountains in 2008 (no previous information on this topic can be found in scientific literature). It came out that more than 100 bird species regularly nest and/or stay here temporarily during their migration! This represents nearly one third of the total 332 species of the avifauna registered in Macedonia – a sufficient incentive for more detailed studies by the biologists!

We believe that you will meet many of the birds during your journey through the region.

GREET THEM!

Art Point – Gumno më 30 shtator zyrtarisht ka përfunduar aktivitetet e projektit “PËRSHËNDETNI ZOGJTË NGA MALI ILNIT DHE PLLAKENIT!” të mbështetur nga Shoqata Ekologjike Maqedonase – SEM dhe Euronatur nga Gjermania.

Falë anketave të zbatuara në rajonin e komunës së Demir Hisarit në periudhën prill – korrik 2015, një pjesë e banorëve lokal kanë identifikuar pothuaj se 90 lloje të zogjve. Këto rezultate ishin krahasuar me rezultatet e fituara nga anëtarët e Sektorit Ernitologjik pranë Shoqatës Hulumtuese të Studentëve Biologë nga Maqedonia që në vitin 2008 kanë zbatuar hulumtimin e parë më të hollësishëm të Malit Ilin dhe Plaken (në literaturë nuk mund gjenden fare të dhëna prej më herët!). Nga kjo doli që në këtë rajon rregullisht vendosin çerdhen dhe/ose përkohësisht, gjatë migracioneve, qëndrojnë rreth 120 lloje të zogjve! Kjo paraqet

më tepër se 1/3 të gjithsej 332 lloje të ornitofaunës së regjistruar në Maqedoni – një nxitje e madhe për hulumtime të reja dhe më të hollësishme nga ana e biologëve!

Në kuadër të këtij projekti, për herë të parë janë bërë hulumtime në pjesën Jaushci që gjendet në afërsi të f. Belçe dhe f. Graishtë (sipërfaqe prej 1.56 ha dhe thellësi maksimale 3 m.). Deri para 30 viteve, nga ky vend është nxjerrë rërë të lumit. Gërmimet e braktisur janë mbushur me ujë, ka filluar të paraqitet vegetacion i frytshëm dhe me atë botë të llojllojshme të gjallë. Sot, në vrimat e shelgjeve, në degët ose përkaj bregut dhe në barin jetojnë ose gjuajnë mbi 40 lloje të zogjve – ky informacion ishte marrë me anë të anketimit të banorëve lokal dhe monitorim të drejtpërdrejtë. Mes tjerave këtu do të vëreni çapjen e bardhë dhe hiri, rosën e egër, komorarin e vogël dhe lejkun, etj. Në ujin notojnë disa lloje të peshqve (klen, shtukë, krap...) por edhe gjarpërinj uji,

breshka dhe vidër...ndërsa fluturojnë edhe helikopterë blu dhe të gjelbër (insekte), mushkonja dhe lloje tjera të insekteve.

Me florën dhe faunën e saj të pasur që duhet të jetë lëndë e hulumtimeve më të hollësishme të biologëve, këto pjesë paraqesin një shembull i vërtetë i eko-sistemit të porsaformuar.

Banorët lokal kanë dhënë informacione interesante që i dinë nga zogjtë dhe çfarë janë përrallat popullore dhe tradita lidhur me ato. Një pjesë e këtyre perlave ishin zbatuar me nxënësit e shkollës së mesme dhe disa shkolla fillore të komunës së Demir Hisarit, ndërsa disa prej tyre ishin të integruar edhe në materiale promotive.

Ishin rekrutuar 10 vullnetarë të rinj – një pjesë e tyre kanë marrë pjesë në inventarizimin e zogjve në Maqedoni dhe në trajnim për përpilimin e propozimeve për projekte.



3. Filloi faza e 3-të e projektit “Lidhja e njerëzve me natyrën – përforcimi dhe rrjetëzimi i shoqatave qytetare në Maqedoni”.

Filloi faza e 3-të e projektit “Lidhja e njerëzve me natyrën – përforcimi dhe rrjetëzimi i shoqatave qytetare në Maqedoni”.

Pas zbatimit të suksesshëm të fazës së 2-të “Art Point – Gumno”, si partner lokal, do të vazhdojë bashkëpunimin me Shoqatën Maqedonase Ekologjike nga Shkupi, Plantlife, organizatë jo-qeveritare nga Britania e Madhe dhe Unioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Natyrës (IUCN).

Me një punëtor hyrës që është mba-

jtur në Shkup nga 25-26 nëntor, organizatorët paralajmëruan vazhdimin e realizimit të fazës së 3-të të projektit me titull “Lidhja e njerëzve me natyrën – përforcimi dhe rrjetëzimi i shoqatave qytetare në Maqedoni”. Projekti paraqet një iniciativë ambicioze për mbrojtjen e llojet e egra të bimëve në vendet e Evropës Juglindore, dhe me fokus në rajonin e Mesdheut. Me kombinimin e përvojave të organizatave siç janë Plantlife dhe IUCN, 11 organizata nga 11 vende të Evropës Juglindore do të tentojnë të transferojnë njohuri dhe

përvoja në nivelin kombëtar në lidhje me llojet e rëndësishme të bimëve dhe vendet ku rriten.

Në Maqedoni ky projekt do të zbatohet në kohëzgjatje prej 18 muajve me aktivitete në rajonet: Dojran, Bogdanci, Perpë dhe Mali i Ilinit (Demir Hisar).

Përveç “Art Point – Gumno”, në realizimin e fazës së 3-të projektit, si partner lokal, do të merr pjesë edhe një anëtare tjetër e Rrjetit për Zhvillim Rural e RM-së – SHQ “Polimat” nga Bogdanci.

8

Ditët e Bletarisë Maqedonase



Shoqata e Bletarëve Nektar nga Manastiri prej 15-18 tetor 2015 në Shirok Sokak në Manastir, në mënyrë tradicionale për herën e gjashtëmbëdhjetë organizon manifestimin nacional “Ditët e Bletarisë Maqedonase” në

të cilën kanë marrë pjesë tridhjetë pjesëmarrës nga gjithë vendi. Vizitorët kishin mundësi personalisht të takohen me prodhuesit dhe të bisedojnë, të provojnë gjitha produktet bletare dhe të blejnë, si dhe të shkëmbejnë kontak-

te për bashkëpunimin e mëtejshëm.

Me rastin e manifestimit shoqata e bletarëve “Nektar” ka publikuar një konkurs me shpërblim për nxënësit e shkollave fillore për përpunimin e veprave artistike dhe letrare në temën “bletari”. Nga veprat e arritura (më tepër se treqind vepra), komisione përkatëse profesionale kanë vendosur se cilat do të jenë të shpërblyera dhe atyre gjatë përfundimit të manifestimit ju ishin dhënë shpërblimet përkatëse, diploma dhe letra falënderimi.





Këshillim rajonal për bletari

Lidhja Rajonale e shoqatave të bletarëve Via Ignacija nga Manastiri në përbërjen e tyre ka shoqata të bletarëve nga gjithë rajoni jugperëndimor i RM-së, gjegjësisht këtu ka anëtarë të shoqatave të bletarëve nga tetë qytete të këtij rajoni.

Lidhja synon realizimin e plotë të qëllimeve të përcaktuara programore, ndërsa e gjithë kjo në interes të anëtarëve.

Në këtë kontekst, ngjashëm me vitet e kaluara, edhe këtë vit, në tetor, ka organizuar këshillim rajonal – ligjëratë profesionale (teorike dhe praktike) dhe në bashkëpunim të ngushtë me SHB Nektar nga Manastiri. Këshillimi ka qenë i vizituar nga mbi 100 bletarë nga rajoni, që edhe njëherë konfirmoi nevojën dhe dobinë e mbindërtimit të vazhduar dhe edukimin si të bletarëve fillestarë ashtu edhe për ata me përvojë më të gjatë në fushën e bletarisë.

Përvojat e reja, zbatimi i metodave të reja si dhe teknologjitë e reja dhe mënyrat e trajtimit të preparateve organike janë gjithsesi një faktor i pashmangshëm në procesin e kultivimit të drejtë dhe cilësor të bletëve si dhe përmirësim dhe rritje të prodhimtarisë së mjaltit dhe produkteve tjera të bletëve.





Panairi i mjaltit në Strugë

Më 22 gusht, në Sheshin e Revolucionit në Strugë, shoqata e bletarëve "Matica", me mbështetjen e Rrjetit për Zhvillim Rural të Republikës së Maqedonisë dhe komuna e Strugës, ka organizuar Panairin e Mjaltit të parë. Qëllimi kryesor i organizatorëve ishte të promovojnë produktet e mjaltit dhe të kontribuojnë për zhvillimin e kësaj dege ekonomike në rajon. Në panairin, produkte të tyre kanë ekspozuar më tepër bletarë nga Shkupi, Shtipi, Radovishi, Koçani, Manastiri, Prilepi, Ohri, Dibra dhe Struga.

Para të pranishmëve në ngjarjen u drejtuan përfaqësuesi i komunës së Strugës, kryetari i shoqatës së bletarëve "Matica", Shefit Shemsedini dhe kryetari i Rrjetit për Zhvillim Rural të Republikës së Maqedonisë, Petar Gjorgievski.

- Prodhimtaria e mjaltit është një degë shumë e rëndësishme në prodhimtarinë e përgjithshme bujqësore sepse ofron një paletë të gjerë dhe të madhe të produkteve. Përveç mjaltit, të rëndësishëm janë dylli, poleni, qumështi...Përzierja e tyre me mjaltin japi produkte që mund të kontribuojnë për të ardhurat e plotë të bletarëve. Mjalti ka rëndësi të madhe në të ushqyerit, por edhe në farmakologji dhe në industrinë e kozmetikës, theksoi Petar Gjorgievski.

Organizatorët kanë tendencë që këtë manifestim të bëjnë një ngjarje tradicionale.





Dita ndërkombëtare e gruas rurale

Në mënyrë tradicionale edhe këtë vit Federata e Fermerëve e Republikës së Maqedonisë në bashkëpunim me Rrjetin për Zhvillim Rural të Republikës së Maqedonisë ka shënuar 15 tetorin – Dita ndërkombëtare e gruas rurale. Ngjarja u zhvillua në f. Josifovo, rajoni i Vallandovës, ku kanë marrë pjesë rreth 150 gra nga mjedise rurale në gjithë vendin. Përveç punimeve tradicionale të përkryera dhe stolitë, gratë e shkathëta kanë ekspozuar edhe ushqim të shijshëm të përgatitur në mënyrë tradicionale dhe karakteristike për rajonin nga i cili kanë origjinën.



Kryetari i Bordit Drejtues i RZR i RM, Vesella Llambevskaja – Domazetova dhe kryetari i Federatës së Fermerëve të RM, Nikolla Stamenov, ju drejtuan të pranishmëve për të treguar për rolin e rëndësishëm të gruas në bujqësinë dhe zhvillimin rural dhe të japin mirënjohjen për mundin dhe kontributin e tyre në ruajtjen e vlerave tradicionale dhe zakoneve. Pas shfaqjes së Shoqatës Kulturore Artistike “Qirili dhe Metodi” nga f. Ilovice, ishin dhënë 6 mirënjohje për gratë anëtare të RZR dhe Federatës së Fermerëve, të cilët kanë dhënë kontribut të veçantë dhe kanë marrë pjesë aktive në realizimin e qëllimeve të organizatës dhe zhvillimit organizativ.





Mësimi gjatë gjithë jetës për zhvillim rural

Në kuadër të Ditëve të Mësimit Gjatë Gjithë Jetës në Republikën e Maqedonisë, Lidhja për zhvillimin e arsimit të të rriturve në Republikën e Maqedonisë (www.srov.mk), me mbështetjen e DVV International Germany, prej 23 deri 25 nëntor 2015 në hotelin Feni në Kavadar ka organizuar punëtori në temën “Mësimi gjatë gjithë jetës për zhvillim rural”.

Qëllimi kryesor i punëtorisë ka qenë të nxitet diskutim dhe të zhvillohen rekomandime për zhvillimin e më-tutjeshëm të mjediseve rurale, duke marrë parasysh arritjet e deritanishme, me mundësi të zbatimit të metodave për arsimin joformal.

Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë si një aktor veçanërisht i rëndësishëm në zhvillimin rural të vendit, ishte ftuar të ndajë përvojat dhe praktikatat e deritanishme para përfaqësuesve të pranishëm të shumë organizatave.





13

U zhvillua LEADER Fest-i i parë në Dellçevë

Qendra Rajonale për Përfaqësim Dellçevë, bashkë me shoqatën Ambrozia, dy anëtare të Rrjetit për Zhvillim Rural, kanë organizuar “**LEADER Fest 2015**” treditör në periudhën prej 2 deri 4 korrik në Dellçevë. Të pranishmit në ngjarjen kanë pasur mundësinë të mësojnë dhe të shkëmbejnë përvoja në lidhje me LEADER, si qasje inovative në sajë të politikës për zhvillim rural të BE-së. Me anë të LEADER qasjes stimulohet përfaqësim të plotë dhe bashkësi të gjithë aktorëve në proceset e krijimit të politikave, marrjes së vendimeve dhe zbatimit të aktiviteteve lidhur me zhvillimin rural. Ajo është një vegël për nxitjen e subjekteve që jetojnë në viset rurale të hulumtojnë mënyra të reja për punë të përbashkët për përmirësimin e kushteve të tyre themelore për jetesë.

LEADER Fest ishte pasuruar me program kulturor-artistik dhe vizitë në teren të praktikave të mira dhe projekte të realizuar në rajonin. Festivalin e mjedisve rurale e kanë vizituar shoqata të ndryshme, komuna, institucione lokale, qytetarë të interesuar nga rajoni i Pellagonisë, Strumicës dhe Bregallnicës, si dhe përfaqësues të një fondacioni dhe dy Grupe Lokale Aksioni (GLA) nga Republika e Çekisë.

Ngjarja ka kontribuar për promovimin e punës së subjekteve që janë të angazhuar në zhvillimin rural dhe ekonominë lokale dhe ka mundësuar rrjetëzim dhe rritje të bashkëpunimit ndër-sektorial. Si rezultat ishin zbuluar mundësi për bashkëpunim me Grupet Lokale Aksioni nga Çekia në kuptim të ngritjes së kapaciteteve dhe zbatimit të përbashkët për iniciativë.

Sipas shembullit të LEADER festivaleve që zhvillohen në gjithë Bashkimin Evropian, Qendra Rajonale për Përfaqësim dhe shoqata Ambrozia, kanë ven-



dosur të themelojnë një praktikë të organizimit të një ngjarjeje të tillë çdo vit, në mikro rajonin Pijanec-Malesh, duke ndryshuar vendin e ngjarjes dhe komunën dhe duke shtuar përmbajtje të reja.

Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë, si aktori kryesor në procesin e afirmimit dhe ngritjes së kapaciteteve në kuadër të LEADER qasjes në Maqedoni, ka mbështetur këtë iniciativë me anë të projektit të USAID për adaptimin e bujqësisë ndaj ndryshimeve klimatike.





14

Promovim i bukurive në mjediset rurale



Promovimi i potencialeve për zhvillim të turizmit rural – STRUGA RURALE” është një iniciativë projekti e zbatuar nga shoqata Qendra Kreative “Rubankult” në bashkëpunim me shoqatën për mundësi të barabarta “Ezerka”. Qëllimi i kësaj iniciative ishte që me anë të një video materiali në të cilën ishin prezantuar resurset natyrore dhe bukuritë, traditën dhe kapacitetet aktuale të akomodimit në 5 fshatra strugane (v. Vevçani, f. Vishni, f. Gorna Belica, f. Radozhda dhe f. Jablanica) të mbështetet promovimi dhe zhvillimi i turizmit rural në rajonin e Strugës. Në ngjarjen e promovimit që ishte zhvilluar më 19 shtator në Strugë, ishin të pranishëm një numër i madh i turistëve të huaj, që konfirmon interesin për këtë lloj të turizmit dhe bukuritë e fshatrave strugane.

Kryetari i Rrjetit për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë, Petar Gjirgievski, mendon që ky rajon ka vende që janë të panjohura, veçanërisht për turistët që vijnë gjatë periudhës veriore, por edhe gjatë gjithë vitit.

- Vendet ishin shfaqur me anë të një materiali video nga e cila mund të vërehen

gjitha bukuritë, ku të gjithë dashamirët e ecjes malore, natyrës madje edhe sporteve ekstreme mund të përdorin dhe gëzohen, tha Georgievski.

Ai theksoi shprehjen që promovimi do të zgjon interes jo vetëm tek turistët, por edhe tek vetëqeverisjet lokale për përmirësimin e infrastrukturës dhe qasjes dhe për zgjerimin e ofertës.

Zore Kalenkoska nga shoqata “Rubankult” paralajmëroi edhe projekte tjera të ngjashme për promovimin e bukurive dhe pasurive natyrore të rajonit të Strugës.

Një iniciativë e ngjashme ishte nxitur dhe zbatuar nga “Zëri i fshatit” dhe Qendra për Zhvillim Rural “Bujrum”. Ata përpiluan një film dokumentar për Gjirin e Bislimit “Ejani!Shihni!Kënaquni! dhe tregoni për bukuritë e Gjirit të Bislimit” që kishte promovimin më 9 shtator në Kumanovë.

– Projekti ka rëndësi të jashtëzakonshme, veçanërisht për rajonin e Kumanovës, pasi që ofron mundësi për zhvillim të turizmit alternativ. Ky rajon është relativisht i panjohur në Maqedoni, veçanërisht për ato që nuk janë nga Kumanova dhe kjo paraqet një mundësi të shkëlqyer që në një mënyrë të tillë projekti të promovohet për zhvillim të mëtutjeshëm të këtij lloj turizmi dhe për investitorët e mundësh që mund të interesohen për zhvillimin e Gjirit të





Bislimit, deklaroi kryetari i Rrjetit për zhvillim rural, Petar Gjorgjevski.

– Projekti duhet të tërheqë investitorët në rajonin mes fshatrave Pčinja dhe Opashac, në rajonin ku shtrihet gjiri, Edhe më parë janë përpiluar studime, konkretisht nga Qendra për zhvillim të rajonit verilindor, që tregojnë se është një vend që mund të shfrytëzohet për zhvillim ekonomik, deklaroi Elizabeta Cvetkovska nga organizata “Zëri i fshatit”.

Gjiri i Bislimit është një unik natyror, që gjendet në rrjedhjen e Pčinjës, në këtë pjesë të Maqedonisë. Karakteristike për të janë disa shpella, llojet endemike të bimëve dhe kafshëve, që ofrojnë mundësi për shfrytëzimin e mundësive për zhvillim të këtij kanioni që shtrihet në hapësirë prej shtatë kilometra.

Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë (RZR i RM) me anë të projektit të USAID për Adaptimin e Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike ka mbështetur iniciativën e projektit të anëtarëve të RZR që kanë pasur për qëllim të promovojnë mjediset rurale dhe të kontribuojnë në zhvillimin e turizmit rural në vend.





15

Ngritja e kapaciteteve për përgatitjen e aplikacioneve për projekte

Rrjeti për Zhvillim Rural i RM-së më 2 dhjetor ka organizuar trajnim për organizatat anëtare, për të përforcuar kapacitetet e tyre dhe të përmirësojë shkathësitë e tyre për përgatitjen e aplikacioneve cilësore për projekte në kuadër të Mekanizmit Projektues si vegël për përmirësimin e punës me projekte në Rrjetin. Pothuaj se 40 përfaqësues të organizatave anëtare të RZR kanë marrë pjesë në trajnimin dhe kanë pasur mundësinë të themelojnë partneritete, bashkëpunim të ndërsjellë dhe përgatitje të përbashkët dhe zbatim të iniciativave të projekteve.

Në kuadër të Mekanizmit Projektues deri më tani ishin publikuar 2 thirrje dhe janë mbështetur gjithsej 11 iniciativa projektuese të anëtarëve të Rrjetit.





16

Zvogëlim të efekteve negative nga ndryshimet klimatike mbi perimet

Më 8 korrik, në f. Dobrejci, rrethina e Strumicës, projekti i USAID për adaptimin e bujqësisë ndaj ndryshimeve klimatike ka demonstruar disa masa bujqësore për adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, të cilat ishin testuar mbi të mbledhura me domate. Me sjelljen e fermerëve dhe këshilltarëve të ANZHBS-së (Agjencia për Nxitjen e Zhvillimit të Bujqësisë) në një prej fushave për testim, projekti i USAID synon të ngrit vetëdijen e fermerëve të Maqedonisë për ndikimet e dëmshme të ndryshimeve klimatike dhe të shkëmbejnë praktika të cilat do të ndihmojnë fermerëve për të përballuar me problemet në kopshtari të shkaktuar nga ndryshimet klimatike.

Ekipi i projektit dhe prof. Dr. Zoran Dimov, eksperti teknik i projektit për kultura nën kulm/mulçim, ka trajtuar shqetësimet e fermerëve dhe kanë sqaruar disa prej strategjive për përshatje të prodhimtarisë bujqësore ndaj ndryshimeve klimatike siç janë: përdorimi i UV rrjeteve mbrojtëse, aplikimi i kërpudhës bamirëse Trihoderma Harzinanium dhe shtresat sintetike.

“Me aplikimin e teknologjive të reja dhe teknikave si vendosja e shtresave të mulçit dhe rrjeteve mbrojtëse dhe trajtimi me kërpudhën Trihoderma Harzinanium, rendimenti me siguri do të rritet për disa herë, të themi për 30 deri 40 %”, - deklaroi për mediat Tome



Timov.

Projekti i USAID për adaptimin e bujqësisë ndaj ndryshimeve klimatike ka filluar të zbatohet në prill të vitit 2012 nga ana e Rrjetit për Zhvillim Rural të RM-së. Qëllimi i projektit është të ndihmohet fermerëve të zmadhojnë nivelin e të ardhurave me anë të zvogëlimit

të dëmeve të shkaktuar nga ndryshimet në mjedisin jetësor. Aktivitetet e projektit janë të fokusuar në zonën mesdhetare, përfshirë edhe Rajonin e Vardarit me pjesë të rrethinës së Strumicës dhe Gjevgjeliës – vise të pasura bujqësore të cilat janë në ndikim më të madh nga ndryshimet klimatike.



17

Zvogëlimi i efekteve negative nga ndryshimet klimatike tek pemët



Më 18 gusht, në f. Mlado Nagoriçane, rrethina e Kumanovës, Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë ka demonstruar rezultatet e fushës së testimit të vendosur me anë të projektit të USAID për Adaptimin e Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike. Duke bartur gjithë aktorët në pëmishte me dardha ku ishin testuar më tepër masa bujqësore për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, projekti synon të përforcojë vetëdijen e sektorit bujqësor maqedonase për efektet negative të ndryshimeve klimatike. Praktikat e zbatuara adaptive dhe rezultatet e arritura në pëmishten do të ndihmojnë fermerëve dhe këshilltarëve të ANZHB-së (Agjencia për Nxitjen e Zhvillimit të Bujqësisë) të mësojnë si të përballohen me problemet që ndryshimet klimatike i shkaktojnë tek kulturat e pemëve.



Ekipi i projektit bashkë me prof. Dr. Marjan Kipirjanovski, ekspert teknik në projektin për pemëtari dhe prof. Dr. Vjekosllav Tanaskoviç, ekspert teknik i projektit për konservim të ujit, i kanë adresuar shqetësimet dhe kanë sqaruar disa prej strategjive për përshtatjen e prodhimit të bujqësore ndaj ndryshimeve klimatike siç janë: përdorimi i UB rrjeteve mbrojtëse, malcimi, mbjellja me barë të fidanëve me kultura me çati, përdorimi i preparateve të ndryshme për mbrojtje të frytit nga djegiet e diellit dhe ndjekja e programit të holësishëm për vaditje dhe fertilizim.





Zvogëlimi i efekteve negative nga ndryshimet klimatike në vreshtarinë



Më 11 gusht, në rrethinën e Negotinës, Rrjeti për Zhvillim Rural të Republikës së Maqedonisë, me anë të projektit të USAID për Adaptimin e Bujqësisë ndaj Ndryshimet Klimatike ka demonstruar disa masa bujqësore për përshtatjen e vreshtarisë ndaj ndryshimeve klimatike, të cilat gjatë 3 viteve të fundit i ka testuar tek rrushit për tryezë. Projekti i USAID-it i ka mbledhur fermerët dhe këshilltarët e NAZHB-së (Agjencisë për Nxitjen e Zhvillimit të Bujqësisë) në një prej fushave testuese të saja, të vendosur në fidanë rrushi, pronësi e Vaska Mojsovska nga Negotina. Duke sqaruar rezultatet dhe përfitimet të zbatimit të masave adaptuese, projekti i USAID synon të ngrit vetëdijen e sektorit bujqësor

maqedonase për ndikimet e dëmshme të ndryshimeve klimatike dhe t'ju ndihmojë fermerëve të përballohen me problemet në vreshtari të shkaktuar nga ndryshimet klimatike.

Ekipi i projektit dhe prof. Dr. Klime Beleski, skeptri teknik i projektit për vreshtari i kanë adresuar brengat e fermerëve dhe kanë sqaruar disa nga strategjitë për përshtatjen e prodhimit të bujqësore ndaj ndryshimeve klimatike siç janë: përdorimi i UV rrjeteve mbrojtëse, përdorimi i kalcium karbonatit dhe T-sistemi i shartimit, të cilat përdoren për mbrojtjen e masës gjethore dhe frytet nga djegiet e diellit. Gjithashtu para të pranishmëve ishte demonstruar procesi i aplikimit të kalcium karbonatit në hardhitë e rrushit.





19

Ulja e ndikimit negativ nga ndryshimet klimatike mbi erozionin e dheut



Më 17 shtator, në Institutin Bujqësor, në komunën e Butelit, rrethina e Shkupit, projekti i USAID për Adaptimin e Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike, i zbatuar nga Rrjeti për Zhvillim Rural i RM-së, ka prezantuar rezultatet e marra nga fusha e testimit që ishte vendosur në vjeshtë të vitit 2012. Qëllimi ishte të përforcohet vetëdija e fermerëve dhe këshilltarëve të AN-ZHB-së (Agjencia për Nxitjen e Zhvillimit të Bujqësisë) për ndikimin negativ të ndryshimeve klimatike mbi erozionin e dheut dhe t'i mësojë si të ulin këto efekte negative me anë të përmirësimit të strukturës së dheut, rritjes së lagështisë dhe materieve ushqyese në dheun.

Ekipi i projektit bashkë me prof. Dr. Dushko Mukaetov nga Instituti Bujqësor i kanë adresuar problemet me erozionin e dheut si rezultat i ndikimit negativ të ndryshimeve klimatike dhe kanë prezantuar masa për përballimin me erozionin në bujqësi: mënyra e përpunimit të dheut – sipas gjatësisë së mbulimit dhe diagonale dhe përdorimi i kulturave mbuluese, të cilat e pengojnë erozionin dhe zmadhojnë nivelin e materieve ushqyese në dheun.





Prezantim të matjeve të nisjes në fushën e blegtorisë

Më 3 dhjetor, në Manastir, dhe më 10 dhjetor në Strumicë, Rrjeti për Zhvillim Rural i RM-së me anë të projektit të USAID për Adaptimin e Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike ka prezantuar matjet fillestare për ndikimin e valës së ngrohtë mbi nivelin e qumështit të lopëve.

Prof. Dr. Metodija Trajčev nga Fakulteti për Shkenca Bujqësore dhe Ushqim ka prezantuar rezultatet e nisjes nga matjet e fituara nga 3 ferma të vogla demonstrative dhe 1 fermë kontroluese, të marra në periudhën e muajve të verës qershor-shtator 2015. Prezantimet i kanë vizituar rreth njëqind përfaqësues të Agjencisë për Nxitjen e Zhvillimit të Bujqësisë – ANZHB dhe blegtor. Me anë të ndarjes së arritjeve dhe rezultateve nga aktivitete të projektit me këshilltarët e ANZHB-së, projekti i USAID synon të zmadhojë vetëdijen në sektorin bujqësor maqedonas për ndikimet e dëmshme të ndryshimeve klimatike dhe të ndajë praktika që do të ndihmojnë blegtorët të përballojnë me problemet e shkaktuara nga ndryshimet klimatike.

Një prezantim tjetër i ngjashëm do të organizohet më 10 dhjetor në Strumicë, ku janë ftuar këshilltarët e ANZHB-së dhe blegtorët e pjesës lindore të Maqedonisë.





21

Shirita mbrojtëse si masë për uljen e erozionit të dheut

Më 15 dhjetor, në afërsi të Liqenit të Tikveshit, projekti i USAID për Adaptimin e Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike i zbatuar nga Rrjeti për Zhvillim Rural të RM-së ka vendosur një shirit mbrojtës nga fidanishte për të zvogëluar erozionin e dheut. Rreth 30 nxënës të Shkollës së Mesme Komunale Pyjore “Gjorqe Petrov” nga Kavadari ishin të kyçur në mbjelljen e pesëdhjetë çempers që do të jenë shiriti mbrojtës së kalimit nga hardhi të rrushit dhe liqenit. Me anë të organizimit të këtij aktiviteti në teren, projekti i USAID synon të rrit vetëdijen tek aktorët e rinj në sektorin bujqësor për ndikimin negativ të ndryshimeve klimatike mbi erozionin dhe t’i mësojë si të zvogëlojnë erozionin e dheut dhe t’i mësojë si të zvogëlojnë erozionin në kushte të terrenit me anë të vendosjes së zonave me vegjetim të përhershëm.

Kjo është një prej masave për përbalimin e erozionit të dheut që promovon projekti. Shiritat mbrojtës e zvogëlojnë rrjedhjen e sipërfaqes, e filtrojnë sedimentin që gjendet në ujërat e rrjedha dhe në atë mënyrë i mbajnë edhe lëndët kimike që gjenden në sedimentin. Ato mund të mbajnë më tepër se 70% të sedimentit dhe mbi 50% të materieve të tretura në ujërat që rrjedhin nëpër terrenet e pjerrtë.





22

Projekti i USAID për Adaptimin e Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike ju ndihmon fermerëve të zvogëlojnë dëmet nga ndryshimet klimatike



Më 21 dhjetor, projekti i USAID për Adaptimi ne Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike ka prezantuar raportin e plotë për zbulimet e fituara nga testimi trevjeçar i praktikave të ndryshme efikase dhe të arsyeshme që do të ndihmojnë fermerëve të zvogëlojnë cenueshmërinë e prodhimitarisë bujqësore nga ndikimi negativ i ndryshimeve klimatike. Projekti ka punuar me 17 fermerë për të përcaktuar masat më efikase adaptuese. Raporti do të jetë i gatshëm për komunitetin më të gjerë bujqësor. Agjencia për Nxitjen e Zhvillimit të Bujqësisë, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor si dhe shumë institucione arsimore dhe shkencore.

Në drejtimin e tij, Drejtori i Misionit të USAID në Maqedoni, theksoi që “ndonëse është një sukses i shkëlqyeshëm, marrëveshja për ndryshimet globale klimatike nënshkruar në Paris në fillim

të këtij muaji nga ana e përfaqësuesve të 195 vendeve, është vetëm hapi i parë në rrugën e gjatë të ri-drejtimin të planetit në rrugën e drejtë. Madje edhe nëse të gjithë synojmë që në mënyrë drastike të zvogëlojmë gazrat e qelqta, shkencëtarët thonë që do të përballemi me këto efekte negative edhe një kohë të gjatë. Përfitimi i një rezistence më të madhe për këto mbetet një prioritet i lartë”.

Ministri i Bujqësisë dhe Drejtori i projektit të USAID për Adaptimin e Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike kanë pasur fjalimet e tyre, para prezantimit e profesorëve të Fakultetit për Shkenca Bujqësore dhe Ushqim dhe Institutit Bujqësor.

Sipas analizave të dhënë në studimin e hershëm të USAID për Adaptimin e Sektorit Bujqësor ndaj Ndryshimeve Klimatike, Maqedonia mund të pret ndryshime ekstreme të temperaturës, më pak periudha me shi por shira më të shpeshta dhe të shkurta dhe inten-

sive që sjellin vërshime dhe erozion të dheut, rrezatim më të madh të diellit, si dhe rritje të nevojës për ujë që vije si rezultat i ngrohtësisë. Meqë gjysma e popullatës rurale në Maqedoni është e varur ekonomikisht, paraqitet nevojë urgjente për zbatimin e aksionit të shpejtë dhe metoda praktike adaptive.

Duke filluar nga prilli 2012, projekti i USAID për Adaptimin e Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike, i zbatuar nga Rrjeti për Zhvillim Rural, ju ndihmon fermerëve të ruajnë rendimentin e tyre me anë të zbutjes së pengesave për rendiment optimal të shkaktuar nga ndryshimet në mjedisin jetësor.

Aktivitetet e projektit janë të përqendruar në zonën e Mesdheut, përfshirë edhe rajonin e Vardarit me pjesë të rrethinës së Strumicës dhe Gjevgjeliës – rajone të pasura bujqësore që janë nën ndikimin më të madh të ndryshimeve klimatike.





23

Dita e Grupit Lokal të Aksionit Bellasicë – Ograzhden



Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë (RZR i RM) gjatë vitit të fundit ka zbatuar aktivitete për pilotim të LEADER qasjes në rajonin juglindor të planifikimit. LEADER qasja, si një prej masave të IPARD, promovon bashkëpunim mes sektorit publik, qytetar dhe afarist dhe i nxit që bashkërisht të hulumtojnë mënyra të reja për përmirësimin e kushteve të tyre themelore të jetës. Në këtë mënyrë LEADER kontribuon për përmirësimin e cilësisë së jetës në mjediset rurale, si për amvisëritë bujqësor ashtu edhe për popullatën më të gjerë rurale.

RZR i RM, gjatë vitit 2014 ka punuar në zhvillimin e kapaciteteve të aktorëve nga 4 komuna të rajonit juglindor të planifikimit – Strumicë, Vasilevë, Bosillovë dhe Novo Sellë, për pjesëmarrje participative dhe vendimmarrje si bazë për metodologjinë LEADER. Grupi i përbërë nga përfaqësues të sektorit publik, qytetar dhe afarist kanë kaluar procesin e planifikimit strategjik, të viuar me përcaktimin e vizionit dhe misionit, qëllimet strategjike, prioritetet dhe përcaktimin e territorit të ardh-

shëm të Grupit Lokal të Aksionit (GLA) “Bellasicë-Ograzhden”. Aktivitetet e zbatuar në këtë rajon kanë mundësuar simulime të gjithë procesit të zbatimit të projekteve për zhvillim rural dhe ju ka ndihmuar pjesëtarëve të ardhshëm të këtij GLA të përfitojnë përvojë praktike.

Në kuadër të këtyre aktiviteteve, ishin realizuar tre pilot projekte: “Harta digjitale turistike e territorit të Bellasicës – Ograzhdenit”, “Krijimi i identitetit vizual të GLA Bellasicë – Ograzhden” që ka përfshirë përpunim të internet faqes, logo, afishe dhe fle-

tushka dhe “Dita e GLA”. Harta digjitale turistike e GLA “Bellasië – Ograzhden” ka mundësuar një pasqyrë të gjitha atraksioneve turistike në këtë rajon. Kjo hartë për dallim nga hartat klasike, përmban më tepër shtresa, ka ndarje tematike dhe përmban informacione në gjuhën maqedonishte dhe anglishte për pasuritë natyrore, kulturore dhe gastronomike nga gjithë territori i GLA Bellasicë – Ograzhden, por edhe informacione për bizneset lokale të industrisë turistike, si restorante, hotele, motele, mjete transporti, agjenci turistike, qendra informative turistike dhe shërbime të ngjashme për zhvillimin e turizmit.

Më 28 shtator 2015 në f. Mokrinë ishte organizuar një ngjarje për promovimin e GLA Bellasicë – Ograzhden në të cilën kanë marrë pjesë me qindra njerëz nga rajoni mes të cilëve edhe përfaqësues të katër komunave. Qendra për zhvillimin e rajonit juglindor të planifikimit, organizata joqeveritare, sektori afarist si dhe sektori arsimor dhe kryetarët e Vasilevës dhe Novo Sellës. Me anë të aktiviteteve të këtij projekti stimulohet prodhimtaria e ushqimit tradicional, ruajtje të valleve dhe kërcimeve tradicionale, përpunimin e veshjeve popullore dhe vepra kulturore tek popullata rurale që do të kontribuojë për promovim më të madh të vlera dhe





mundësive të rajonit dhe do të nxit zhvillimin e turizmit rural dhe zhvillimin ekonomik.

Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë me anë të komponentit për ngritjen e vetëdijes publike dhe ngritjen e kapaciteteve të organizatave qytetare, si pjesë e projektit të USAID për adaptimin e bujqësisë ndaj ndryshimeve klimatike, në mënyrë intensive punon në procesin e ngritjes së kapaciteteve të sektorit joqeveritar. Ky sektor është pjesë integrale e LEADER metodologjisë që paraqet një qasje participative dhe përfshirje të aktorëve të ndryshëm nga mjediset rurale në procesin e vendimmarrjes të rëndësishme për komunitetet e tyre. Nga kjo, RZR i RM sheh rëndësinë e prezantimit të metodologjisë së LEADER qasjes para aktorëve të ndryshëm në mjediset rurale.



Klima ndryshon, nga ne varet

Në Bogovinë, fëmijët e gjashtë shkollave komunale, me shumë argëtim dhe lojë, kanë mësuar për pasojat e dëmshme të ndryshimeve klimatike si dhe mënyrën e zvogëlimit të efekteve negative mbi mjedisin lokal. Ngjarja ishte organizuar në kuadër të fushatës “Klima ndryshon, nga ne varet”, që e zbaton projekti i USAID për strategji komunale për ndryshimet klimatike.

Rrjeti për Zhvillim Rural të Republikës së Maqedonisë si zbatues i projektit të USAID për Adaptim të Bujqësisë ndaj

Ndryshimeve Klimatike, e vizitoi ngjarjen dhe të pranishmëve ju shpërndau fanella dhe broshura që sqarojnë më tepër masa për përshtatjen e bujqësisë ndaj ndryshimeve klimatike.





25

Konferenca për LEADER/ZLUK në Milano

Më 24 dhe 25 dhjetor në Milano, Itali, kryetari i Rrjetit për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë (RZR i RM-së), Petar Gjorgievski, bashkë me anëtarët tjerë të Rrjetit Ballkanik për Zhvillim Rural (RBZR) kanë marrë pjesë në Konferencën për LEADER/ZLUK (Zhvillimi Lokal i Ud-hëhequr nga Komuniteti) me titullin *"Përforsimi i zhvillimit lokal me anë të bashkëpunimit"*.

Konferenca ishte organizuar nga Rrjeti Evropian për Zhvillim Rural (REZR) dhe DG AGRI (Drejtoria për Bujqësi) në sajë të Ekspo Milano 2015. Qëllimi i përgjithshëm i ngjarjes ishte të përmirësohet zbatimi i LEADER/ZLUK, me fokus të veçantë mbi përforsimin e kapaciteteve të Rrjetit Kombëtar Rural (RKR) për dhënien e mbështetjes përkatëse dhe drejtime për LEADER/ZLUK të gjithë aktorëve dhe nxitja e bashkëpunimit trans-nacional dhe ndër-territorial.



Petar Gjorgievski ka prezantuar punën e RBZR si platformë rajonale e rrjeteve për zhvillim rural në Ballkanin Perëndimor të themeluar si organizata

joqeveritare. Ai sqaroi synimet e këtij Rrjeti, fushat e saja prioritare dhe qëllimi kryesor që ka të bëjë përforsimi i shoqërisë qytetare dhe promovimi i shkëmbimeve multi-kombëtare për zhvillimin rural, veçanërisht mes vendeve anëtare të BE-së dhe vendet në aderim. Rrjetet Rurale për Zhvillim Rural të Kroacisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Maqedonisë, Serbisë, Malit të Zi dhe Kosovës, si anëtare të RBZR i kanë prezantuar para të pranishmëve aktivitetet e tyre dhe arritjet në nivelin kombëtar dhe rajonal. Platforma e RBZR është një strukturë që jep vlerë rrjeteve të Ballkanit Perëndimor në drejtim të bashkëpunimit të tyre më të afërt dhe artikullim të interesave të përbashkëta, me anë të planifikimit të përbashkët të projekteve për plotësimin e nevojave të popullatës rurale.

Konferenca për LEADER/ZLUK ka pasur për qëllim të promovojë mësimin e përbashkët mes anëtarëve të LEADER/ZLUK për përmirësimi në furnizimit





dhe harmonizimin e rregullave për projekte të përbashkëta; të potencojnë mënyrën e zbatimit të metodologjive për zhvillim lokal në mjedise të tyre në Evropë dhe jashtë dhe të ofrojnë mundësi për bashkëpunim mes partneriteteve lokale në kuadër të BE-së, por edhe me vendet fqinje dhe në nivelin global.



26

E gjithë Evropa do të jetojë! Njerëzit nga viset rurale në Evropë i afirmojnë të drejtat e tyre

Në Parlamentin e Dytë Evropian, të organizuar nga 4 deri 6 nëntor, në Sharding, Austri, ku kanë marrë pjesë 240 përfaqësues të komuniteteve rurale nga 40 vende evropiane, mes të cilëve edhe Rrejt për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë, ishte miratuar një dokument me titullin Manifesti Rural Evropian. Me këtë thirrjet për njohje të plotë të të drejtave të komuniteteve rurale për një jetë cilësore dhe standarde jetësor të barabartë me atë që ka popullata urbane, si dhe pjesëmarrje të plotë në proceset politike.

Manifesti, me të cilin përfaqësohen akcione për 30 çështje kryesore, paraqet një rezultat i fushatave nacionale në 40





vende, në të cilët ishin përfshirë mijëra banorë të viseve rurale.

Ata thirrën për partneritet të rinovuar dhe barabartë mes njerëzve dhe pushtetit. Ishte theksuar që njerëzit nga viset rurale kanë përgjegjësi për të vepruar ndaj mirëqenies së tyre, por kanë kërkuar nga pushtetet në gjitha nivelet, përfshirë edhe ato evropiane, të punojnë që ky partneritet kryesor të ketë efekt.

Parlamenti Evropian ka thirrur Bashkimin Evropian të përgatit një pasqyrë kryesore të kushteve në fushat rurale në kuadër të BE-së. Konkluzionet nga kjo pasqyrë duhet të reflektohen në fokus më të gjerë mbi fushat rurale në gjitha programet relevante dhe fonde të BE-së. Fushata e Parlamentit Rural Evropian do të vazhdojë gjatë dy viteve vijuese në drejtim të ndikimit mbi përgatitjet e politikave për periudhë pas vitit 2020.

Pjesëmarrësit në Parlamentin Rural Evropian ishin dëshmitarë që qyteti Sharding, në të cilin zhvillohej mbledhja, në ditë merr 2000 refugjatë në drejtimin e tyre në kufirin mes Austrisë dhe Gjermanisë. Për shumë fusha rurale, kjo paraqet një mundësi për të integruar refugjatët dhe të tjerët të rinj, nëse realizohet nevoja nga krijimi i vendeve të punës, si investim në strehim, shërbime dhe infrastrukturë. Parlamenti Rural Evropian ka thirrur për një pritje më të ngrohtë të bazuar mbi solidaritetet mes tjerëve.

